


BARAZIA NË

Barazi



Pa dallime Llojllojshmëri

Demokracia

DEMOKRACI

BASHKIMI DEMOKRATIK

ALBION (10), DIELZA (10), ENEA (10), ORGES (10), DITJON (10), AJA (10), LISIAN (10), ELIOT (10),
ADEA (10), KLODIAN (10)




Ne në këtë artikull kemi biseduar dhe kemi shkruar për demokracinë te ne dhe në botë

Ne kemi biseduar për demokracinë. Demokracia ka bazi gjinore dhe të drejta për çdo njeri. Fjala demokraci rjedh nga greqishtja, „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Demokracia u krijua Athinë të Greqisë rreth 2500 vjet më parë, pra në vitin 507 para erës sonë. Në atë kohë në Athinë, për të marrë vendime politike kanë pasur të drejtë vetëm athinasit, burrat mbi moshën 18 vjeçare dhe të pasurit. Kurse gratë, të moshuarit dhe të vafërit nuk kanë pasur të drejtë të marrin pjesë. Por, demokracia u zhvillua shumë. Tani gratë kanë të drejtat e barabarta me burrat, dhe të moshuarit nuk janë më të diskriminuar. Disa nga të drejta tona janë: e drejta e të jetuarit, e drejta për të luajtur, për strehim, për të pasur familje, e drejta e shkollimit, etj.

Demokracia lidhet shumë me fjalën liri. Ne e dimë

se demokracia është një gjë shumë e rëndësishme, sepse lidhet me të drejtat dhe liritë e njeriut. Ne gjithashtu biseduam për diskriminimin e vajzave në disa vende të botës. Ne kemi dy lloje të demokracisë: demokracia direkte dhe ajo përfaqësuese. Demokraci do të thotë një vend i lirë me shumë të drejta. Edhe në Kosovë ka demokraci, që do të thotë se kemi të drejta të barabarta. Ne jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik.



Barazia gjinore



Grupi punues i artikullit



Gazetarët e Kuvendit

DEPUTETI SOT

SHKËLQIM (10), ERDA (10), ART (11), SUADA (10), RIGË (10), ELONA (10), LEONI (10), ELTONI (10),
DIJANE (10), ENSAR (10)

Ne jemi klasa V-2 nga shkolla „MODEL“ dhe ne sot do t'iu tregojmë se si e kemi zgjedhur deputetin

Ne sot e kemi zgjedhur deputetin e partisë së „Ananasit“. Ne kemi shkruar planprogramet për secilën parti. Pasi i lexuam të gjithë këto planprograme rreth punës që do ta bëjmë nëse zgjedhemi si parti, ne e zgjodhëm fituesin. Fituesi ishte „Partia e Ananasit“ me më së shumti vota.


Ne sot votuam gjatë Punëtorisë, por kur të bëhemi 18 vjeçarë do të votojmë në procesin zgjedhor për të zgjedhur kryetarin e komunës ose deputetët. Në shkollin 17, qytetarët filluan të votojnë për herë të parë, por vetëm burrat kishin të drejtë për votim. Zgjedhjet sot bëhen pa dallim gjinie, për gra apo për burra. Ne gjithashtu, kemi mësuar për deputetët se si duhet të sillen ata me qytetarët e Kosovës.



Fotoja e ditës



Partia Ananasi duke lexuar programin e tij



Duke vizatuar gjatë Punëtorisë



Grupi „Rrushi“

QYTETARËT NË NJË VEND DEMOKRATIK

ANISA (10), ERJON (10), ANDA (9), ORNELA (10), ELSA (10), VESA (10), ENES (10), DIONIS (10),
EJON (10), YLL (10)



Shembull i një qytetari të mirë është kur përveç të drejtave, ai i kryen edhe përgjegjësitë e tij

Të jetosh në një vend demokratik do të thotë të kesh të drejta dhe rregulla. Në një shtet demokratik duhet që të ketë kontribues, të cilët japin më të mirën për shtetin e tyre, e ata jemi ne qytetarët. Por, për të pasur një vend të mirë demokratik duhet që të gjithë të shprehin mendimin e tyre. Kosova është një shtet demokratik, vend i cili u siguron qytetarëve të vet të drejta të barabarta pa dallim kombësie, race, ngjyre, feje, gjinie, niveli ekonomik, niveli shoqëror, etj.

Të drejtat tona si qytetarë të demokracisë janë: e drejta për të jetuar, e drejta e ushqimit, e drejta e të pasurit familje, e drejta e shoqërisë, e drejta e të shprehurit lirshëm, e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur, por kjo e drejtë mund të apikohet vetëm pasi që t'i mbushim 18 vjeç. Ne si qytetarë, gjithashtu i kryejmë edhe përgjegjësitë tona, e ato përgjegjësi janë: ta mbrojmë ambientin dhe mos ta ndotim atë, t'i respektojmë të tjerët, ta respektojmë ligjin dhe të mos biejmë ndesh me të, t'i ndihmojmë njerëzit të cilët kanë nevojë për ne, t'i paguajmë taksat me rregull, etj.

Ne gjithashtu mund të jemi edhe qytetarë aktiv, ku mund të marrim pjesë në organizime të ndryshme për të pastruar qytetin, apo organizime për dhurimin e gjakut.



Mbroje ambientin, mos e ndot atë!



Ne, gazetarët e Kuvendit

KUVENDI ËSHTË SHTËPIA JONË

JON (10), DARIS (10), RUMEJSA (10), ERIK (10), RIGA (10), ENSAR (10), GENTA (10), RRONI (10), SUELA (10), RIAR (10)



Kuvendi si institucion demokratik

Kuvendi së pari, siç e thamë është institucion demokratik i cili merr vendime për popullin dhe vendin tonë. Ai ndryshe quhet „Shtëpia e Popullit“. Aty punojnë deputetët të cilët e zgjedhin edhe Presidentin e vendit. Kjo sepse populli ynë voton për deputetët, kurse deputetët votojnë për President. Në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë, nga ata janë 100 qytetarë shumicë dhe 20 nga komunitetet jo shumicë si për shembull: romë, serb, egjiptian, etj.

Kuvendi ka disa detyra e ato janë: të na ndihmojë neve, pra popullin, të zgjidh problemet tona, ta udhëheq popullin, të miratoj ligje, etj.

Kuvendi mban mbledhje për zgjidhjet e problemeve që quhet seanca plenare. Këto seanca mbahen normalisht një herë në javë. Deputetët që i votojmë ne, duhet të kenë disa cilësi të caktuara. Disa nga këto cilësi të mira sipas nesh janë: të jenë zemërmirë, bujar, të sin-

qertë, besnik, të mençur, etj. Këto cilësi janë të rëndësishme, sepse vota jonë duhet t'i jepet një njeriut të denjë. Qeveria jep projektligjet dhe i dërgon në Kuvend dhe më pas ata mund t'i miratojnë ose jo.

Seancat plenare transmetohen në televizionet tona, për shkak se ne duhet të dimë se çka duhet të flitet në Kuvend. Porosia jonë është kjo: ki guxim dhe voto kandidatin e duhur, sepse ne jemi e ardhmja e Kuvendit.



Autorët e artikullit - Grupi „Qershia“

Mendimet tona rreth Kuvendit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë